

Shtojca 10

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[06/04/2023]

Drejtuar: **Gjergj Buça P.F**

Adresa: Durres Lagjja nr.14, Hyrja e Autostrades Durres - Tirane, km1

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, Mall

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-61664-03-07-2023

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje dru zjarri e pellet për QEA”

Fondi limit: 39.996.000 (Tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 150 ditë

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Data [13 mars 2023]
Nr [24]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Gjergj Buça P.F me Nipt: K 31331547 R me vlerë të ofertës 39,889,800
(tridhjet e nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë.
2. PISHA shpk me Nipt K 12526207 V me vlerë të ofertës 39,942,900
(tridhjet e nëntë milion e nëntëqind e dyzetë e dy mijë e nëntëqind) lekë.
3. WOODPECKER shpk me Nipt L 23109601 T me vlerë të ofertës 39,945,024
(tridhjet e nëntë milion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet e katër) lekë
4. REDI PELLET shpk me Nipt L 54202003 S me vlerë të ofertës 18,709,000
(tetëmbëdhjetë milion e shatëqind e nëntë) lekë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Për ofertuesin **PISHA shpk me Nipt: K 12526207 V** me vlerë të ofertës 39,942,900 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **Pisha shpk me Nipt: K 12526207 V:**

1. Nuk disponon Lejen mjedisore të tipit B “Veprimtaritë e lëndës së drurit” sipas pikës 2.3 b të shtojcës 7 pika 2.3 “Kapaciteti teknik”
2. Nuk disponon “Formularin e sigurimit të ofertës” sipas shtojcës 3.
3. Nuk disponon Certifikatën ISO 9001 sipas pikës 2.3.4 të shtojcës 7 pika 2.3 “Kapaciteti teknik”.
4. Nuk disponon dokumentacionin për punonjësit e kualifikuar sipas pikës 2.3.1 a dhe b të shtojcës 7 pika 2.3 “Kapaciteti teknik”.
5. . Nuk disponon dokumentacionin për mjetet dhe pajisjet sipas pikës 2.3.3 të shtojcës 7 pika 2.3 “Kapaciteti teknik”.

Për ofertuesin **REDI PELLET shpk me Nipt: L 54202003 S** me vlerë të ofertës 18,709,000 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **REDI PELLET shpk me Nipt: L 54202003 S:**

1. Në “Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit” pjesa e II-të, pika b “Deklarata e dorëzimit të ofertave të pavarura” pika 6 a dhe b nuk është çekuar as pika a as pika b.
2. Certifikata ISO 9001 me nr AL979649 nuk përfshin aktivitetin e druve të zjarrit si edhe në mungesë të QR ose barcode-it nuk mund të verifikohet vlefshmëria e saj.
3. Në “Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit” pjesa e III-të pika b “Deklarata për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, mungojnë të dhënat konkrete të kërkuara nga formulari, si edhe nga dokumentacioni i shoqërues, punonjësit e specializuar janë mobiliere dhe jo punonjës druri sipas kërkesës së specifikimeve teknike. Gjithashtu në mungesë të listëpagesës bashkëngjitur nuk mund të vërtetohet se punonjësit e lartpërmendur janë të Ofertuesit apo jo.
4. Në shtojcën 7 pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” ku kërkohet dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, Ofertuesi ka bashkëngjitur kontratën me “Elg Energy Mon Ike” si edhe faturat përkatëse. Komisioni kontrollon faturat dhe konstatoi se në asnjërën prej tyre nuk kishte tregëtim drush zjarri sipas kërkesës së DT.
5. Në shtojcën 7 pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika b, kërkohet paraqitja e bilanceve të viteve 2019, 2020, 2021. Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin bashkëngjitur për këtë pikë, konstatoi se Ofertuesi ndodhet nëkushtet e përcaktimeve të ligjit nr 10091 dt 05.03.2008 neni 41, pra duhet të kishte paraqitur edhe akt ekspertizat nga Eksperti Kontabël i Autorizuar, të cilat mungojnë, në shkelje të “Kriterëve të veçanta të kualifikimit” pika 2.2, pika b.

Për ofertuesin **WOODPECKER** shpk me Nipt: L 32109601 T me vlerë të ofertës 39,945,024 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik WOODPECKER shpk me Nipt: L 32109601 T:

1. Në shtojcën 7 pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” ku kërkohet dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, Ofertuesi nuk disponon fare xhiro për vitet 2019 dhe 2020 ndërsa për vitin 2021 disponon një xhiro simbolike.
2. Nuk disponon “Formularin e sigurimit të ofertës” sipas shtojcës 3.
3. Nuk disponon Certifikatën ISO 9001 sipas pikës 2.3.4 të shtojcës 7 pika 2.3 “Kapaciteti teknik”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [Gjergj Buça P.F me adresë: Durrës Lagjja nr.14, Hyrja e Autostrades Durrës - Tiranë, km1], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 39,889,800 (tridhjet e nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e nënte mijë e tetëqind) lekë./ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.